



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:276116  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05631899

**C.nr.2826/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H.Z. etj, që të gjithë nga Komuna e Pejës, të cilët i përfaqëson Faruk Binakaj, avokat në Pejë, sipas autorizimit, kundër të paditurve M.V. etj, që të gjithë nga Komuna e Pejës, me bazë juridike vërtetimin pronësie në bazë të mbajtjes, vlera e kontestit 3.001 euro, jashtë seance me datën 29.04.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. NDËRPRITET PROCEDURA** në këtë çështje kontestimore C.nr.2826/21, për shkak të vdekjes së të paditurës P.M. nga Komuna e Pejës.

**II.** Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të paditurës (të ndjerës) e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret Gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

**A r s y e t i m**

Paditësit H.Z. etj, që të gjithë nga Komuna e Pejës, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datën 08.12.2021, kanë parashtruar padi ndaj këtu të paditurve M.V. etj, që të gjithë nga Komuna e Pejës, me bazë juridike vërtetimin pronësie në bazë të mbajtjes, vlera e kontestit 3.001 euro.

Gjykata sipas dispozitave ligjore të LPK, me të pranuar padinë dhe provat e bashkangjitura, ka kërkuar me aktvendimin e datës 15.03.2024 nga paditësit që të plotësojnë padinë me adresën e saktë të vendbanimit për të paditurit, mirëpo i autorizuari i paditësve nuk ka mundur të sigurojë adresën e saktë për të paditurit, andaj gjykata i është drejtuar Zyrës për Regjistrimin e Gjendjes Civile të Komunës së Pejës, e datës 19.03.2024, sipas të cilës kërkesë zyra për Regjistrimin e Gjendjes Civile të Komunës së Pejës, me datën 20.03.2024 ka njoftuar gjykatën se për të paditurit M.V. etj, që të gjithë nga Komuna e Pejës, nuk ka asnjë shënim, ndërsa e paditura P.M. ka vdekur në Pejë, me datën 28.11.2010, ku i është bashkëngjitur certifikata e vdekjes me numër serik. V10669666, e datës 20.03.2024.

Prandaj, gjykata pas vlerësimit të kësaj situatë, nxjerr përfundim se janë plotësuar kushte ligjore që të bëhet ndërprerja e procedurës në këtë kontest në kuptim të dispozitës së nenit 277 par. 1 pika a) të LPK-së, për shkak të vdekjes së të paditurit, sipas të cilit nen përcaktohet se *“Procesi gjyqësor ndërpritet kur pala ndërgjyqëse vdes ose humb gjyqësinë procedurale”*, i ndryshuar me nenin 18 të Ligji nr. 04/L-118 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore.

Ndërsa me dispozitën e nenit 280 të LPK-së, thuhet se: *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjore, administratori i falimentimit apo paraardhësi juridik i personit juridik, merr përsipër procedurën apo kur i thirret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”*.

Ndërsa me dispozitën e nenit, 329 par 1 të LPK-së, është përcaktuar shprehimisht: *“Fuqia provuese e shkresave, shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. 329.2 të LPK-së, të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike”*.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 142, 277 pika ( a) dhe nenit 387 pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së).

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2826/21, me datë 29.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.